



VENDIM

Nr.24 Datë 21.03.2014

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ÇEZ TRADE ALBANIA” SH.P.K PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LIÇENSAVE: NR.
91 SERIA TE10P DHE NR. 92 SERIA FP10K DHËNË ME
VENDIMET NR. 1 DHE NR. 2 DATË 20.01.2010 TË BORDIT TË
KOMISIONERVE TË ERE-S PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9; 18 pika 1 germa “e”, të Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe në zbatim të nenit 5 të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së Liçensës”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, mbasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s, lidhur me heqjen e liçensës shoqërisë CEZ Trade Albania sh.p.k,

Konstatohet se:

- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k me vendimin nr. 1, datë 20.01.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me liçensën nr. 91 Seria TE10P, për veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike të vlefshme për një afat 5 vjeçar.
- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k me vendimin nr. 2 datë 20.01.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është pajisur me liçensën nr. 92 Seria FP10K, për aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, të vlefshme për një afat 5 vjeçar.
- ERE me vendimin nr. 13 datë 03.03.2014, miratoi kërkesën e OST sh.a për zgjidhjen e “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg”, të lidhur ndërmjet CEZ Trade Albania sh.p.k në cilësinë e Tregtuesit të Energjisë Elektrike dhe OST sh.a – OT dhe kërkesën e OST sh.a zgjidhjen e “Marrëveshjes për

Pjesëmarrjen në Treg”, të lidhur ndërmjet CEZ Trade Albania sh.p.k në cilësinë e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike dhe OST sh.a – OT.

- CEZ Trade Albania sh.p.k, me shkresën nr. 12/26 Prot., datë 26.12.2013, (depozituar ne OST) njofton se kjo shoqëri i është nënshtruar procesit të likuidimit.
- Shoqëria “CEZ Trade Albania” sh.p.k me shkresën nr. 1058 Prot, datë 27.12.2013, ka kërkuar nga ERE fillimin e procedurave për heqjen e licensave të sipërcituara duke qënë se është shoqëri në likuidim dhe dëshiron të dalë nga tregu i energjisë elektrike me vullnetin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë CEZ Trade Albania sh.p.k, për heqjen e licensës me nr. 91 Seria TE10P , miratuar me Vendimin nr. 1, datë 20.01.2010 të Bordit te Komisionerëve te ERE-s, për veprimtarinë e Tregtimit te Energjisë Elektrike, të vlefshme për një afat 5 vjeçar.
2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë CEZ Trade Albania sh.p.k, për heqjen e licensës me nr. 92 Seria FP10K, miratuar me Vendimin nr. 2 datë 20.01.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për aktivitetin e Furnizuesit te Kualifikuar te Energjisë Elektrike, të vlefshme për një afat 5 vjeçar.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë CEZ Trade Albania sh.p.k, për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.